REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës:	2022:000948
Datë:	24.05.2023
Numri i dokumentit:	04319820

P.nr.7/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci me pjesëmarrjen e bashkpunëtores profesionale, Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit A (L) M nga Peja ku dhe tani banon në rruga ,,.. K.Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale ,,Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge '' nga neni 269 par.2 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr. PP//II.nr.2649/2021 datës,30.12.2021,në shqyrtimin fillesar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Lumturije Hoxha, nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurit të lartcekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë,03.05.2023 në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 24.05.2023, e përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

Kundër:

A M, i lindur me datë:.. në Pejë ku dhe tani banon në rruga ,, .. K.Pejë, nga babai L dhe nëna F e gjinisë B, i martuar, baba i dy fëmijve, ka të kryer shkollën e mesme, punon punëtor fizik, i identifikuar me nr. Personal:.., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt.17.12.2021 rreth orës 03:00 në Klinë pikërisht në Sheshin ,,Nëna Tereza'' për herë të parë pa autorizim posedon narkotik më pak se tre gram dhe atë narkotikun e llojit Mariuhunë me peshë neto 0,3 gram, në atë mënyrë që i pandehuri pasi siguron narkotikun e lartëcekur, të njëjtin e merr me vete dhe më pas derisa ishte në veturën ndalohet nga Policia e Kosovës, të cilët gjatë kontrollit në veturë e gjejnë narkotikun e sipërcekur dhe një mulli për bluerjen e saj, të cilat edhe i sekuestrojnë.

-Me çka ka kryer vepër penale,, Posedim i paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge''nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 43 dhe 69 dhe 185 par 1, nen par 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së:

GJYKON
DËNIM ME GJOBË

I. Me dënim me gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqindë**)** €uro, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës.
III. Obligohet i pandehuri qe te paguaj konform nenit 453 par 1, i KPPRK-së, shpenzimet e paushallit gjyqësor vlera në shumë prej 20 euro dhe për kompensimin e viktimave te krimit 20 euro, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale
Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr.2649/2021 datës ,30.12.2021, kundër të pandehurit,A M nga Peja -K.Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar për veprën penale,,Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë,03.05.2023, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurorja e Shtetit, Lumturije Hoxha nga Prokuroria Themelore në Pejë, i akuzuari A (L) M.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurorja e shtetit, i pandehuri deklaroj se: e pranojë fajësinë për veprën penale që më vihet në barrë, se më vjen keq për rastin që ka ndodhur, nuk do ta përsërisë më, pendohem për veprën e kryer, i premtoj Gjykatës që në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, më parë nuk kam pasë problem.

2022:000949

Gjykata kërkon mendimin e Prokurores të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.
Prokurorja e shtetit, Lumturije Hoxha deklaroj sa ai përket pranimit të fajësisë i propozojë gjykatës që ta bëjë ketë pranim fajësie pasi që është bërë me vullnetin e tij të lirë i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë pranimit, po ashtu ky pranim ka mbështetje në provat që gjenden shkresat lëndes.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë
Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 të KPPK-së. Në këtë aspekt Gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e Gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
3.Gjendja faktike e vërtetuar:
Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:
Se i akuzuari, ka kryer veprën penale,Posedim i paautorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor:
Duke u bazuar në këto qe u cekën më lart, Gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se si e ka pranuar edhe vet.
5.Rrehtanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:
Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.
Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, është penduar për veprën e kryer, dhe që i njëjti nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë vepër. Ndërsa, Gjykata sa i përket rrethanave rënduese, gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

2022:000949

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqind**)** €uro, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
Dënimi me gjobë të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.
Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë qe të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet u mor konform nenit 453 par. 1 të KPRK-së.
Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 248 dhe nenit 365 dhe 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.7/2022, me datë 24.05.2023

Bashkëpunëtore profesionale — Gjyqtarja
Fatmire Elezaj — Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

2022:000949